



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 23, dt. 10.06.2024

### MBI MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT MIDIS "REPUBLIKA E TURKIYE, MINISTERIA E KULTURËS DHE TURIZMIT, AGJENCIA TURKE PËR BASHKËPUNIM DHE KOORDINIM (TIKA) DHE REPUBLIKA E SHQIPËRISË, KËSHILLI I QARKUT KORÇË"

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Vendimi i Këshillit të Qarkut Nr. 25 dt 21.12.2023 "Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024, mbi bazën e dispozitave të "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turkiye dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zhvillim dhe Statusin e Zyrës së koordinimit të Programit TIKÀ-s në Shqipëri,

### VENDOSI

1. Të miratojë Protokollin e Bashkëpunimit midis "Republika e Turkiye, Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (Tika) dhe Republika e Shqipërisë, Këshilli i Qarkut Korçë", (*Template i protokollit i bashkëngjitur*).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerëzore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KRYETAR I KËSHILLIT TË QARKUT

Erjon Nexhipi


Miratuar me / 15 / Vota  
Vota Pro / 15 /  
Vota Kundër / 0 /  
Vota Abstenim / 0 /  
Zbardhur më datë /10/06/2024



Konceptoi: M. Alickolli

Konfirmoi: M. Bylykbashi

Sekretari: B. Muco



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

**RELACION**

**“MBI MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË BASHKËPUNIMIT MIDIS "REPUBLIKA E TURKIYE, MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT, AGJENCIA TURKE PËR BASHKËPUNIM DHE KOORDINIM (TIKA) DHE REPUBLIKA E SHQIPËRISË, KËSHILLI I QARKUT KORÇË”**

**I. QËLLIMI I P/VENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij P/Vendimi është miratimi i protokollit të bashkëpunimit midis:

**REPUBLIKA E TURKIYE, MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT, AGJENCIA TURKE PËR BASHKËPUNIM DHE KOORDINIM (TIKA)  
DHE  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË, KËSHILLI I QARKUT KORÇË**

Në kuadër të zbatimit të projektit: “NXITJA E TË RINJVE NË BUJQËSI DHE MBËSHTETJA E BLETARISË MODERNE NË QARKUN E KORÇËS”, në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Vendimi i Këshillit të Qarkut Nr. 25 dt 21.12.2023 “Mbi miratimin e Buxnetit të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024, mbi bazën e dispozitave të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turkiye dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zëvillim dhe Statusin e Zyrës së koordinimit të Programit TIKA-s në Shqipëri.

**II. VLERËSIMI I P/VENDIMIT**

Ky projektvendim hartohet në përputhje me politikat e Qeverisë Shqiptare mbi marrëdhëniet ndërkombëtare si dhe në përputhje me angazhimin e saj në përmbushje të standardeve ndërkombëtare në bujqësi.

**III. ARGUMENTIMI I P/VENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

P/ Vendimi është i lidhur me zbatimin e projektit “NXITJA E TË RINJVE NË BUJQËSI DHE MBËSHTETJA E BLETARISË MODERNE NË QARKUN E KORÇËS”, një Program pilot i bletarisë i prezantuar nga Këshilli i Qarkut Korçë dhe i mbështetur nga TIKA, që propozon Ndërtimin e një Modeli Rajonal Apikulturë Rinore – Sipërmarrje, diversifikimin e ekonomisë rurale dhe mbrojtjen e traditave lokale në bletari nëpërmjet mbështetjes të të rinjve në transformimin e ideve të tyre sipërmarrëse dhe inovatore, duke ofruar mundësi konkrete në ndërtimin e një karrierë të qëndrueshme.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

P/vendimi është hartuar në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 7, Vendimi i Këshillit të Qarkut Nr. 25 dt 21.12.2023 “Mbi miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Korçë për vitin 2024, dhe mbi bazën e dispozitave të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turkiye dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zhvillim dhe Statusin e Zyrës së koordinimit të Programit TIKa-s në Shqipëri.

#### **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË P/VENDIMIT**

P/vendimi është i organizuar si më poshtë:

- **Në pikën 1** parashikohet miratimi i Protokollit të Bashkëpunimit midis “Republika e Turkiye, Ministria e Kulturës dhe Turizmit, Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (Tika) dhe Republika e Shqipërisë, Këshilli i Qarkut Korçë”.

#### **VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E P/VENDIMIT**

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij P/Vendimi është Këshilli i Qarkut Korçë, Sektori i Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve, Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Territorit.

#### **VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E P/VENDIMIT**

P/Vendimi është hartuar nga një grup pune në Këshillin e Qarkut Korçë, të përbërë nga Kabineti i Kryetarit, ekspertë të projekteve për Bashkimin Evropian dhe specialistë të zyrës të DAMT – Korçë.

#### **II. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Hyrja në fuqi e këtij vendimi nuk shoqërohet me efekt financiar për buxhetin e shtetit.

#### **KABINETI I KRYETARIT**

Këshilltari për Projektet e BE:

**Mariela Aličkoll**

**Dt. 03.06.2024**

**PROTOKOLL BASHKEPUNIMI  
MIDIS  
REPUBLIKA E TÛRKIYE  
MINISTRIA E KULTURËS DHE TURIZMIT  
AGJENCIA TURKE PËR BASHKËPUNIM DHE KOORDINIM (TİKA)  
DHE  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYESIA E KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË**

**PËR PROJEKTIN:  
“NXITJA E TË RINJVE NË BUJQËSI DHE MBËSHTETJA E BLETARISË MODERNE NË  
QARKUN E KORÇËS”**

**NENI 1**

**PALËT**

Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit të Republikës së Turkiye (në vijim referuar si “TIKA”) dhe Këshilli i Qarkut Korçë të Republikës së Shqipërisë, (në vijim referuar së bashku si “Palët”),

Mbi bazën e dispozitave të “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turkiye dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin për Zhvillim dhe Statusin e Zyrës së Koordinimit të Programit të TİKA-s në Shqipëri”, nënshkruar në Ankara më 20 shkurt 2024, për të forcuar dhe zhvilluar lidhjet e miqësisë mes dy vendeve dhe marrëdhëniet teknike, shkencore dhe ekonomike në kuadër të bashkëpunimit në fushën e bujqësisë, kanë rënë dakord për çështjet e mëposhtme.

**NENI 2**

**QËLLIMI**

Qëllimi i këtij protokoll është përcaktimi i detyrimeve të “Palëve” për realizimin e projektit “Nxitja e të rinjve në bujqësi dhe mbështetja e bletarisë moderne në qarkun Korçë” ndërmjet “TİKA” dhe “Këshillit të Qarkut Korçë”.

**NENI 3**

**DETYRIMET E PALËVE**

**3.1 Detyrimet e TİKA-s:**

- 3.1.1 Të sigurojë pajisjet bazë të bletarisë, detajet e të cilave janë paraqitur në aneksin e këtij protokollit, në përputhje me legjislacionin të cilit i nënshtrohet TİKA;
- 3.1.2 Të përgatisë dokumentet teknike të pajisjeve që do të merren në kuadër të projektit dhe t'ia paraqesë ato Këshillit të Qarkut Korçë për shqyrtim dhe miratim;
- 3.1.3 Të realizojë prokurimin e materialeve;
- 3.1.4 Të përfundojë procedurat e kontrollit dhe pranimin në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë;
- 3.1.5 Të sigurohet që logot (tabelat) promovuese që tregojnë se projekti është kryer në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë të vendosen në pajisjet që do të prokurohen.

### **3.2 Detyrimet e Këshillit të Qarkut Korçë:**

- 3.2.1 Të përcaktojë përmbajtjen dhe pedagogët për trajnimin që do të ofrohet në kuadër të projektit, në bashkëpunim me TİKA-n;
- 3.2.2 Të përzgjedhë bletarët e rinj që do të përfitojnë nga projekti, në bashkëpunim me TİKA-n;
- 3.2.3 Të sigurojë familjet e bletëve nga rajoni për përfituesit pas dorëzimit të koshereve që do të jepen në kuadër të projektit;
- 3.2.4 Të sigurojë transportin ndërqytetës, ushqimin, kostot e akomodimit dhe materialet e trajnimit të bletarëve të rinj në kuadër të programit të trajnimit, detajet e të cilit janë paraqitur në aneksin e këtij protokollit;
- 3.2.5 Të nënshkruajë një kontratë tre (3) vjeçare me bletarët për të siguruar që pajisjet që do të sigurohen nga projekti të mos shiten apo keqpërdoren;
- 3.2.6 Të organizojë ceremoninë e dorëzimit të pajisjeve tek bletarët dhe të informojë bletarët;
- 3.2.7 Të krijojë shërbimin e inspektimit pas dorëzimit të pajisjeve tek bletarët, të caktojë personel për këtë qëllim, të sigurojë mbështetje logjistike dhe të veprojë së bashku me TİKA-n në këtë drejtim;
- 3.2.8 Të marrë të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit (të cilat duhet të merren nga Këshilli i Qarkut Korçë dhe të gjitha institucionet përkatëse);
- 3.2.9 Të përgatisë dhe t'i dorëzojë TİKA-s një raport mbi rezultatet e projektit pas gjashtë (6) muajsh.

### **3.3 Detyrimet e Përbashkëta:**

- 3.3.1 Vendimet për problemet që mund të lindin në zbatimin e projektit do të merren nga përfaqësuesit e TİKA-s dhe Këshillit të Qarkut Korçë;
- 3.3.2 TİKA dhe Këshilli i Qarkut Korçë do të marrin vendime të përbashkëta për përgatitjen e kritereve dhe përzgjedhjen e përfituesve nga Komisioni;
- 3.3.3 Me hyrjen në fuqi të Protokollit, informacioni për personelin ndërlidhës që do të përcaktohet nga palët dhe informacione të reja në rast ndryshimesh do t'u njoftohen palëve të tjera.

#### NENI 4

### HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

Ky Protokoll do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi nga ajo datë deri në dorëzimin dhe marrjen e projektit.

#### NENI 5

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 5.1 Në rast nevoje, mund të bëhen ndryshime dhe shtesa në protokoll me shkrim me pëlqimin e të dyja palëve;
- 5.2 Në rast se lindin çështje për të cilat nuk ka dispozitë në Protokoll, mund të bëhet një protokoll shtesë ose çështja mund të rregullohet me marrëveshje të përbasnkët me shkrim;
- 5.3 Çdo mendim i ndryshëm apo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë zbatimit të Protokollit do të zgjidhet përmes konsultimit dhe negociimit;
- 5.4 Ky Protokoll është hartuar në qytetin e Korçës më / /2024 në 2 kopje, secila në gjuhët turke dhe shqipe, dhe të gjitha tekstat janë nënshkruar me të njëjtën vlefshmëri.

**Republika e Turkiye**  
**Ministria e Kulturës dhe Turizmit**  
**Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe**  
**Koordinim (TIKA)**

.....  
**Mustafa ATA**  
**Koordinator**

**Republika e Shqipërisë**  
**Këshilli i Qarkut Korçë**

.....  
**Erjon NEXHIPI**  
**Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë**